



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Janar-nëntor 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtje - ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtorinë e Arsimit, viti 2016 e karakterizon një ndër vitet më të suksesshme dhe me rezultate të shumta, ku gjatë kësaj periudhe kohore janar-nëntor 2016, janë realizuar me sukses dhe efikasitet të lartë, të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë në katër (IV) nivelet e arsimit parauniversitar dhe njëkohësisht punë dhe detyra të tjera të paraqitura gjatë këtij intervali kohor.

Edukimi dhe arsimimi i nxënësve në institucionet edukativo-arsimore të komunës së Prishtinës, zhvillohet në gjuhën amtare për të gjitha nacionalitetet (shqipe, serbe, boshnjake dhe turke).

I. Institucionet parashkollore:

Në komunën e Prishtinës, gjatë vitit shkollor **2015/2016**, veprimtarinë e vet edukativo-arsimore e kanë zhvilluar tetë (8) institucione parashkollore publike,

pesë (5) IP me bazë në komunitet dhe një IP publiko-privat, me 114 grup-mosha, gjithsej 2044 fëmijë të të gjitha grup-moshave, prej të cilëve dy fëmijë (2) të nacionalitetit boshnjak, njëmbëdhjetë (11) të nacionalitetit turk dhe një (1) fëmijë i komunitetit goran.

Po ashtu, në komunën e Prishtinës veprojnë edhe dyzet e dy (42) institucione parashkollore private, të cilat janë të licencuara nga MASHT-i, por mungojnë statistikat për numrin e fëmijëve.

II. Institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët

Në komunën e Prishtinës, gjatë vitit shkollor 2015/2016, veprimtarinë edukativo-arsimore e kanë zhvilluar 43 institucione edukativo-arsimore, me 18 paralele të ndara, me gjithsej 33141 nxënës, të organizuar në 1404 paralele, prej të cilëve 18 nxënës të nacionalitetit boshnjak, 67 të nacionalitetit ashkali, 3 të nacionalitetit rom, 64 nxënës të nacionalitetit serb, 161 nxënës të nacionalitetit turk dhe 2 të nacionalitetit goran.

Ndërsa, aktivitetin edukativo-arsimor kanë zhvilluar edhe shtatë (7) shkolla private, me gjithsej 1406 nxënës.

Në institucionet e arsimit fillor të komunës së Prishtinës, gjatë vitit shkollor 2015/2016, në paralelet e arsimit parafillor kanë qenë të regjistruar 2202 nxënës, të sistemuar në 92 paralele. Ndërsa në klasën e parë kanë qenë të regjistruar 3476 nxënës, të sistemuar në 142 paralele.

III Institucionet e arsimit të mesëm të lartë

Në vitin shkollor 2015/2016, në komunën e Prishtinës, veprimtaria edukativo-arsimore është zhvilluar në 13 institucione edukativo-arsimore, me 10125 nxënës, të sistemuar në 342 paralele, prej tyre 10 nxënës të nacionalitetit boshnjak, 88 nxënës të nacionalitetit turk, 5 të nacionalitetit ashkali dhe një (1) nxënës i komunitetit goran. Aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe nëntë (9) shkolla private, me gjithsej 910 nxënës.

Në të gjitha institucionet publike punojnë 3150 mësimdhënës dhe personel tjetër tekniko-administrativ dhe udhëheqës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit parauniversitar;
- Vizita informuese në gjitha institucionet edukativo-arsimore;
- Mentorimi i shkollave gjatë tërë vitit;
- Përgatitjet për zhvillimin e garës "Olimpiada Matematike";
- Organizimi i garës "Olimpiada Kombëtare e Kosovës në Kimi";
- Organizimi i garës "Shkencëtari i Ri";
- Organizimi i aktivitetit për shënimin e 22 Marsit - Ditës Botërore të Ujërave; dhe 23 Marsit - Ditës Botërore të Meteorologjisë;
- Shënimin e Ditës Botërore të Poezisë;
- Trajnimi permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);
- Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Arsimit për përdorimin e "Portalit për mësim elektronik";
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme: FE, drejtoritë komunale, bibliotekat, muzeun, klubet sportive etj.;
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike në aspektin e sigurisë së institucioneve të arsimit parauniversitar;
- Bashkëpunimi i Zyrës për siguri në shkolla me drejtoritë dhe mekanizmat tjerë komunal dhe qendror;
- Përgatitja e raportit për ecurinë e procesit edukativo-arsimor në tremujor e parë të gjysmëvjetorit të dytë: ku përfshin notimi e nxënësve për çdo lëndë, orët e planifikuara dhe të mbajtura, procesverbalet e mbajtura me këshillin e arsimtarëve, prindërve, mungesat e nxënësve;
- Analizë dhe statistikë e suksesit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015/16;
- Përgatitja e informatës për suksesin e përgjithshëm të nxënësve dhe suksesin për secilën lëndë të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015/16;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për ecurinë e procesit edukativo-arsimor në tremujorin e parë të gjysmëvjetorit të dytë 2015/16;
- Përgatitja e raportit për rezultatet e arritura gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015/16;
- Përpunimi i të dhënave për testin e Arritshmërisë, krijimi i listave me nxënës, të ndarë nëpër paralele me nga 15-17 nxënës (paralele e përgjysmuar);
- Përpunimi i të dhënave, krijimi i qendrave testuese (gjithsej 11 qendra), ku do të organizohet mbajtja e testit të Arritshmërisë;

- Caktimi i administruesve nëpër qendra testuese, ku do të administrojnë testin e arritshmërisë dhe janë përgjegjës rreth mbarëvajtjes së testit nëpër dhoma testuese;
- Analizë rezultateve të arritura në Testin e arritshmërisë dhe Testin shtetëror të maturës;
- Organizimin dhe mbajtjen e Testit shtetëror të maturës;
- Organizimi dhe zhvillimi i Testit shtetëror të maturës, afati i gushtit 2016;
- Hartimi i planeve të punës për funksionimin e Këshillit të prindërve të komunës;
- Implementimi i mekanizmave të krijuara dhe formularëve standardë për përzgjedhjen e kuadrit udhëheqës-menaxhues dhe profesional nëpër shkolla;
- Hapja e konkurseve për personel të ri, në përputhje me nevojat e institucioneve edukativo-arsimore;
- Formimi i komisioneve profesionale për intervistimin e kandidatëve, për mësimdhënës në institucionet edukativo-arsimore;
- Përfshirja e përfaqësuesve të Këshillit Drejtues, prindërve dhe komunitetit në procesin e përzgjedhjes së kuadrit edukativo-arsimor;
- Angazhimi i profesionistëve-ekspertëve në panelet e përzgjedhjes;
- Vizita speciale në të gjitha institucionet e nivelit parashkollor, për të kontrolluar ecurinë e procesit dhe a janë duke u realizuar aktivitete e planifikuara në orarin e pasditës;
- Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve në nivel shkolle;
- Fillimi i zbatimit të mësimin tërëditor në shkollat pilot;
- Krijimi i skemave për stimulimin e menaxhimit të suksesshëm në institucionet edukativo-arsimore;
- Zbatimi i stimulimit për sukses në menaxhimin e institucionet edukativo-arsimore;
- Formimi i grupit punues me përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit, për përcaktimin e hartës së shkollave (zoonimi);
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2015/16 dhe konsultime me MASHT;
- Punësimi i personelit të ri në përputhje me nevojat;
- Themelimi i paraleleve të reja parashkollore në kuadër të shkollave fillore (bashkëpunim me MASHT);
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta;
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë;

- Shpallja e konkursit për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore;
- Themelimi i institucioneve parashkollore me komunitetin në bazë;
- Marrja e vendimit për riorganizimin e rrjetit të shkollave;
- Organizimi i trajnimeve për stafin menaxhues, në përputhje me nevoja dhe planet e trajnimeve;
- Organizimi i aktiviteteve të praktikës profesionale, në bashkëpunim me ndërmarrjet publike dhe private;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i FNV dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i ekspozitës me nxënësit e nivelit parauniversitar dhe përzgjedhja e pikturave më të mira;
- Organizimi i aktivitetit për shënimin e 22 Marsit, Ditës Botërore të Ujërave dhe 23 Marsit, Ditës Botërore të Meteorologjisë;
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;
- Furnizimi i kuzhinës qendrore në mënyrë sistematike me produkte ushqimore;
- Furnizimi i institucioneve parashkollore me mjete didaktike dhe rikuizita;
- Identifikimi i shkollave që kanë hapësirë për zhvillimin e mësimi tërë-ditor;
- Sigurimi i sistemit të komunikimit në mes të DKA dhe shkollave;
- Fuqizimi i Zyrës për siguri në shkolla;
- Evidentimi i të gjitha shkollave që kanë Këshillat drejtuese të themeluara sipas Ligjit për arsimin parauniversitar;
- Furnizimi i shkollave me pako minimale të mjeteve të konkretizimit, përfshirë pajisjet laboratorike;
- Pajisja e shkollave me kënde të leximit;
- Pajisja me punëtori dhe me firma ushtrimore në shkollat profesionale;
- Procesimi i të dhënave në sistemin SMIA për të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar;
- Mbledhja e të dhënave për përvojën e mësimdhënësve 1990/99;
- Implementimi i Protokollit për parandalimin dhe referimin e akteve të dhunës në arsimin parauniversitar;
- Shfrytëzimi i sigurt i internetit në shkolla;
- Publikimi në ueb-faqe të Komunës i listës së institucioneve parashkollore publike dhe private, të licencuara;
- Vlerësimi i tenderit "Transporti i nxënësve në viset rurale" në Prokurim;
- Vlerësimi i tenderit "Furnizimi me libra për bibliotekat shkollore, pjesa e dytë" në Prokurim;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me libra shkollor;

- Pajisja e bibliotekave shkollore me literaturë profesionale, tekste mësimore dhe libra (bashkëpunim me bibliotekat në nivel komune dhe vendi, me komunitetin);
- Shpërndarja e listave të pagave nëpër institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme, në mënyrë elektronike;
- Ruajtja e listave të pagave nëpër follderë për secilin muaj kalendarik;
- Kalkulimi i retroaktiveve të shkollave fillore dhe të mesme të muajit shkurt 2016;
- Përcjellja e kontratës "Rregullimi i xhamave në institucionet aarsimore dhe nevojat e Komunës";
- Fillimi i furnizimit me inventar për institucionet arsimore në bazë të kontratës të vitit 2015;
- Filli i furnizimit me pajisje teknologjike i shkollave në bazë të kontratës të vitit 2016;
- Vazhdimi i furnizimit me naftë për institucionet arsimore në bazë të nevojave të tyre;
- Përgatitja e tenderit për dezinfektimin dhe deratizimin e institucioneve arsimore ;
- Regjistrimi në databazë i të gjitha lëndëve të paguara të financave etj.;
- Përgatitja e lëndës për fillimin e procedurave për prokurim për material didaktik për shkolla;
- Përgatitja e lëndës për fillimin e procedurave për prokurim për material higjienik për institucione arsimore;
- Përgatitja e lëndës për fillimin e procedurave për pajisjet psikologjike;
- Përgatitja e lëndës për fillimin e procedurave për prokurim për material didaktik për shkolla;
- Përgatitja e lëndës për fillimin e procedurave për prokurim për furnizimin e kuzhinës qendrore të çerdheve me pajisje për kuzhinë;
- Fillimi i furnizimit të institucioneve arsimore me inventar, në bazë të kontratës së vitit 2015;
- Fillimi i furnizimit të institucioneve arsimore me pajisje teknologjike (kompjuterë, llaptopë, projektorë) etj.;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja dhe kompletimi i lëndëve për "Petty-Cash";
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga Banka Botërore;
- Kërkesat për transportin e nxënësve dhe arsimtareve, si dhe fëmijëve me nevoja të veçanta;

- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Përgatitja e raportit tremujor;
- Furnizimi i institucioneve shkollore me material didaktik, material higjienik;
- Furnizimi i institucioneve me lëndë djegëse naftë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese, kthyese dhe të përgjithshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë vitit 2016, ka realizuar **48** vizita informuese, **30** vizita speciale, **50** vizita kontrolluese, **15** vizita kthyese dhe **65** vizita të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Zyrtarët e arsimit gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik, plan-programet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimdhënësve sipas planit, mbështetur në kapacitetet e drejtorisë, kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të punësuarve tjerë nëpër shkolla. Kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve në mësim

sipas periodave mësimore. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësime eventuale, sipas nevojës;

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, ka realizuar organizimin dhe mbajtjen e garës “Olimpiada Matematike”, në nivel komune. Në këtë garë kanë marrë pjesë 110 nxënës të klasave IX-XII nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore publiko dhe private;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim e projektin “SAEK” i UNDP-së, kanë realizuar garën me nxënësit e shkollave të mesme të larta për esenë më të mirë, me temë “Çka është korrupsioni”. Tri shkollat fitues: SHML “Eqrem Çabej”, “Sami Frashëri”-II dhe SHML “28 Nëntori”, janë shpërblye nga ky projekt me kompjuter, rafte të librave, si dhe materiale me praktika të mira të përfshirjes së rinisë në aktivitete anti-korrupsion;
- Organizimi i testit diagnostifikues për nxënësit e riatdhesuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe MPB-në;
- Ndarja e shpërblimeve për hartimin e Planeve zhvillimore të shkollave nga organizata GIZ;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Prishtinës, më 21 mars kanë organizuar program kulturor-artistik me nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar, për nder të Ditës Botërore të Poezisë, të shpallur nga organizata e specializuar UNESCO në vitin 1999, në kongresin e 30 të mbajtur në Paris, ku vendimi i marrë në këtë kongres ka objektiv kryesor promovimin dhe mbështetjen e diversitetit linguistik përmes shprehjes poetike. Në shënim të Ditës së Poezisë, në secilën shkollë të komunës së Prishtinës është organizuar gara për poezinë më të mirë, ku komisioni i formuar nga aktivet profesionale brenda shkollave përkatëse ka bërë përzgjedhjen e pesë poezive më të mira, ndërsa poezia më e mirë përfaqëson shkollën në nivel komune. Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë, kanë formuar komisionin dhe kanë përzgjedhur tri poezitë më të mira për nivelin e arsimit të mesëm të ultë dhe tri poezitë më të mira të nivelit të arsimit të mesëm të lartë;
- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, kanë realizuar ekspozitën me punime të nxënësve të nivelit parauniversitar, nga data 02-07 mars 2016, me temë “7 dhe 8 Marsi”. Ekspozita është mbajtur në objektin e Galerisë së Fakultetit të Arteve, ku në këtë ekspozitë, secili institucion edukativo-arsimore është përfaqësuar me nga pesë punime të punuar nga nxënësit e shkollave të tyre. Ndërsa, komisioni i profesional i formuar nga profesor të Fakultetit të Artit, ka përzgjedhur tri punime më të mira të nivelit fillor dhe tri të nivelit të mesëm të lartë në nivel komune;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për të shënuar 22 Marsin - Ditën Botërore të Ujërave

dhe 23 Marsin - Ditës Botërore të Meteorologjisë, kanë organizuar ekspozitë me nxënësit e shkollave fillore;

- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Prishtinës, për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe 8 Marsit - Ditës së Gruas, kanë realizuar program kulturor-artistik.
Po ashtu, me këtë rast Drejtoria e Arsimit ka ndarë mirënjohje dhe dhurata për mësime dhënë, drejtor dhe veteranë të arsimit, për kontributin e dhënë në arsim dhe edukim të gjeneratave;
- Më 15.04.2016, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës organizoi Olimpiadën Kombëtare të Kosovës në Kimi, në të cilën morën pjesë rreth 60 nxënës të klasave IX-X, nga të gjitha shkollat publike dhe private. Gara u mbajt në objektin e Gjimnazit Matematik, duke filluar nga ora 10:00. Në Olimpiadën Kombëtare të Kimisë, secila shkollë është përfaqësuar me nxënës që ka treguar rezultate të larta në nivel shkolle. Ndërsa, nxënësit që treguan rezultate të mira në nivel komune, do e përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi, më 15 maj 2016. Olimpiada Ndërkombëtare e Kimisë sivjet mbahet në Gjeorgji. Mirëpo Republika e Kosovës këtë vit dhe vitin e ardhshëm, nuk mund të marrë pjesë në këto gara me të drejta të plota, ku sipas rregullores së ICHO, Republika e Kosovës është pranuar që në vitin 2016/2017 të marrë pjesë vetëm si vëzhgues. Por, sipas rregullores së ICHO, Republika e Kosovës nga vitin 2018 do të marrë pjesë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Kimisë, me përfaqësuesit finalist të olimpiadës kombëtare si anëtare me të drejta të plota;
- Më 29.04.2016, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, organizoi për herë të parë garën "Shkencëtari i Ri", ku pjesëmarrës ishin 30 nxënës të klasave të XII, të shkollave publike dhe private, të cilët pasi kanë treguar rezultate të larta në shkollat e tyre, iu nënshtruan testit në nivel komune në lëndët e kimisë, fizikë dhe të biologjisë. Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është identifikimi i talenteve të ri, nxjerrja në pah të shkathtësive, kompetencave të arritura në shkencat natyrore dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional. Drejtoria e Arsimit, në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsim dhe veçanti në shkencat natyrore, ka dhënë kontribut të madh, ku nga viti 2015 deri sot ka pajisur 32 institucione edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar, me 94 kabinet të fizikës, kimisë dhe biologjisë, duke krijuar kushte të standardeve bashkëkohore, për një mësimdhënie-nxënie cilësore. Në procesin e organizimit të Olimpiadës së Kimisë, janë angazhuar edhe mësime dhënë të lëndës së kimisë, të cilët kanë dhënë kontribut të çmueshëm në formulimin e pyetjeve, nga të cilat më pas drejtoria ka realizuar përpilimin e testeve. Testi dhe gjithë procesi i Olimpiadës së Kimisë është administruar dhe monitoruar nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe mësime dhënësit e kimisë;
- Përgatitja e raportit mbi zhvillimin dhe rezultatet e arritura në garën "Shkencëtari i Ri";

- Drejtoria e Arsimit, gjatë kësaj periudhe raportuese ka organizuar Garën e Diturisë, të realizuar në tetë lëndë të shkencave natyrore dhe shoqërore në: gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë angleze, matematikë, fizikë, kimi, biologji, histori dhe në lëndën e gjeografisë. Gara është organizuar dhe zhvilluar me nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët, konkretisht nxënësit e klasave të nënta (IX), ku pjesëmarrës ishin 315 nxënës, të shkollave publike dhe private, të cilët përfaqësuan shkollën në nivel komune, pasi kishin treguar rezultate të larta në shkollat e tyre;
- Është përgatitë raporti mbi organizimin e garave të shumta të organizuara gjatë vitit shkollor 2015/16, si: “Olimpiadën Matematike”, “Olimpiadën Kombëtare të Kosovës në Kimi”, “Shkencëtarin e Ri”, “Garat e Diturisë – Prishtina 2016”, garën për esenë më të mirë, garën për poezinë më të mirë dhe garën për pikturën më të mirë, me nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Realizimi i informatës për ecurinë e procesit edukativo-arsimor në tre mujorin e parë të gjysmëvjetorit të dytë: ku përfshin notimi e nxënësve për çdo lëndë, orët e planifikuara dhe të mbajtura, procesverbalet e mbajtura me këshillin e arsimtarëve, prindërve, mungesat e nxënësve;
- Analizë dhe statistikë suksesit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015/16;
- Përgatitja e raportit rreth mungesave të mësimdhënësve në shkolla fillore dhe të mesme të larta gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015/16;
- Përgatitja e raportit për suksesin e arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2015/16, për secilën lëndë të nivelit parauniversitar;
- Përpunimi i të dhënave për ecurinë e procesit edukativo-arsimor në tre mujorin e parë të gjysmëvjetorit të dytë 2015/16, duke përfshirë: aktivitetet e mësimdhënësve rreth mbarëvajtjes së ecurisë së procesit mësimor, notimi për secilën lëndë sipas Udhëzimeve Administrative për vlerësim, takimet me këshillin e arsimtarëve, prindërve, orët e planifikuara dhe të mbajtura, mungesat e nxënësve;
- Përgatitjen e raportit për suksesin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015/16. Pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme të realizuar mbi rezultatet e arritura të nxënësve në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015/16, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor konstatojmë, se në këtë gjysmëvjetor ka ngritje të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e Prishtinës, në raport me suksesin dhe rezultatet e vitit paraprak;
- Përgatitja e të dhënave për organizimin e Testin të arritshmërisë dhe përcaktimi i nxënësve për paralele;
- Përcaktimi dhe organizimi i qendrave për mbajtjen e testit të Arritshmërisë;
- Caktimi i administruesve dhe monitoruesve të cilët do të sigurojnë mbarëvajtjen e Testit të arritshmërisë;

- Më 21 maj 2016, nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të Arsimit, u organizua Testi i arritshmërisë në nivel vendi me nxënësit e klasave të nënta (IX), ku këtij testit në komunën e Prishtinës ju nënshtruan 3961 nxënës. Drejtoria e Arsimit, në kohë optimale ka bërë të gjitha përgatitjet e domosdoshme për një proces të drejtë, duke organizuar testin në njëmbëdhjetë (11) qendra, me qëllim krijimin e kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe shpresojmë në rezultate më të mira dhe reale;
- Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, ka realizuar formën e organizimit të Testit të arritshmërisë, një nxënës një bankë, dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi;
- Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre për Testin shtetëror të maturës 2016, krijimi i qendrave testuese dhe organizimi i nxënësve nëpër dhoma testuese me klasë të përgjysmuara;
- Më 04 qershor 2016, nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit, u organizua Testi shtetëror i maturës në nivel vendi me nxënësit e klasave të dymbëdhjeta (XII), ku këtij testit në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 4795 nxënës. Drejtoria e Arsimit, në kohë optimale ka bërë të gjitha përgatitjet e domosdoshme për një proces të drejtë, duke organizuar testin në njëzetedy (22) qendra dhe tridhjetë e katër (34) nënqendra, me qëllim krijimin e kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe shpresojmë në rezultate më të mira dhe reale. Po ashtu, për këtë proces Drejtoria e Arsimit ka angazhuar 304 monitorues dhe administrues, të cilët kanë qenë të ngarkuar për mbikëqyrjen e Testit shtetëror të maturës në komunat tjera të Republikës së Kosovës, Drejtoria e Arsimit ka organizuar dhe siguruar transportimin e tyre dhe në kohën e duhur janë shpërnda në qendrat e caktuara;
- Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, ka realizuar formën e organizimit të Testit shtetëror të maturës, një nxënës një bankë, dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi;
- Më 27 gusht dhe 3 shtator 2016, nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të Arsimit, u organizua Testi shtetëror i maturës në nivel vendi, me nxënësit e klasave të dymbëdhjeta (XII). Këtij testit në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 1356 nxënës, të cilët nuk arritën të shënojnë rezultate në afatin e qershorit. Drejtoria e Arsimit në kohë optimale, i ka bërë të gjitha përgatitjet e domosdoshme për një proces të drejtë, duke organizuar testin në nëntë (9) **qendra** dhe katërbëdhjetë (14) **nënqendra**, me qëllim të krijimit të kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar

pozitivisht në mbarëvajtjen e testit. Për këtë proces Drejtoria e Arsimit ka angazhuar 86 monitorues dhe administrues, të cilët kanë qenë të ngarkuar për mbikëqyrjen e Testit shtetëror të maturës në komunat tjera të Republikës së Kosovës. Drejtoria e Arsimit ka organizuar dhe siguruar transportimin e tyre dhe në kohën e duhur dhe janë shpërndarë në qendrat e caktuara;

- Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me American School of Kosova, kanë organizuar samitin “Kosovo Learning Summit”, ku pjesëmarrës ishin 150 mësues të komunës së Prishtinës, me qëllim bashkëpunimi dhe inspirimi për zbatimin e planprogrameve të reja dhe metodave efektive të mësimit, të cilat janë zhvilluar në bazë të hulumtimeve të fundit në fushën e arsimit dhe duke u bazuar në praktikën më të mirë botërore;
- Në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme/MPB-së, është duke u zhvilluar fushata “Kundër trafikimit me qenie njerëzore”, organizimi ka filluar nga 18 tetori i vitit 2016 dhe do të zgjasë deri më 17 nëntor 2016, dhe njëkohësisht do vazhdohet edhe me aktivitete përkatëse pas fushatës;
- Është realizuar analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm mbi rezultatet e arritura nga nxënësit e klasave të nënta (IX) dhe të dymbëdhjeta (XII) në testet e vlerësimit të jashtëm (Testin i arritshmërisë dhe Testin shtetëror i maturës), ku nga ky vlerësim i bërë konstatohet se ka ngritje të theksuar të rezultateve të nxënësve, në raport me vitin paraprak;
- Mbajtja e testit me klasat V me karakter hulumtues, të organizuar nga MASHT-i nëpër disa shkolla fillore të komunës së Prishtinës;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar publik dhe privat, për përgatitjen e vlerësimit ndërkombëtar “PISA-2018”, ku vitin e ardhshëm do realizohet pilotimi i këtij vlerësimi (2017);
- Gjatë muajit tetor janë grumbulluar dhe përpunuar të dhënat mbi numrin e nxënësve, personelit arsimor dhe gjendjes së objekteve shkollore, për të gjitha institucionet e nivelin të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2016/17;
- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015/16;
- Organizimi i trajnimeve permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);
- Trajnimi i 10 zyrtarëve të Drejtorisë së Arsimit për përdorimin e “Portalit për mësim elektronik”;
- Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kanë organizuar garën “Lexim artistik”, për poezi dhe prozë, me nxënës të shkollave fillore për nder të Ditës Botërore të Librit;
- Është realizuar mbajtja e testit pilotues në gjashtë shkolla fillore të komunës së Prishtinës, ku testit iu kanë nënshtruar nxënësit e klasave të pesta;
- Në muajin qershor, Drejtoria e Arsimit ka organizuar ceremoninë e ndarjes së certifikatave, mirënjohjeve dhe shpërblimeve për drejtuesit e

institucioneve edukativo-arsimore dhe nxënësit e nivelit të mesëm të ulët dhe të lartë, të cilët treguan rezultate të larta në garat e shumta të organizuar nga DKA-ja, gjatë vitit shkollor 2015/16;

- Në muajin qershor, në tetë institucionet parashkollore është hapur konkursi për pranimin e 433 fëmijëve, për vitin shkollor 2016/17;
- Drejtoria e Arsimit, në kohë të planifikuar ka realizuar konkursin për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore, ku për vitin edukativ 2016/17, janë regjistruar gjithsej 440 fëmijë;
- Drejtoria e Arsimit, për vitin shkollor 2016/17, ka planifikuar të regjistrojë në klasën e **dhjetë (X)**, gjimnaze dhe shkolla profesionale **3674 nxënës**, të shpërndarë në **115 paralele**. Në afatin e qershorit, kushtet dhe kriteret e pranimit i kanë plotësuar **3038 nxënës**, ku regjistrimi i nxënësve është realizuar duke i respektuar në përpikëri kushtet dhe kriteret të caktuar nga MASHT-i, dhe Udhëzimi Administrativ nr. 22/2013, numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës.
Ndërsa, në afatin e gushtit në shkollat e nivelit të arsimit të mesëm të lartë, janë shpallur **603 vende të lira** në gjimnaze dhe shkolla profesionale;
- Po ashtu, për vitin shkollor 2016/17, në nivelin e arsimit fillor janë planifikuar të regjistrohen 3489 nxënës të shpërndarë në 145 paralele, ku deri tani janë regjistruar gjithsej 3233 nxënës;
- Në muajin korrik, Drejtoria e Arsimit ka organizuar takim me drejtuesit e institucioneve të nivelit parauniversitar, ku janë prezantuar raporti i suksesit të gjysmëvjetorit të dytë, raporti i garave të realizuar gjatë vitit shkollor 2016, si dhe planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në klasë të parë (I) dhe të dhjetë (X), për vitin shkollor 2016/17;
- Në muajin gusht, Drejtoria e Arsimit ka organizuar takim me drejtuesit e institucioneve të nivelit të arsimit parauniversitar, takimi i cili kishte karakter informues dhe bashkëpunues rreth përgatitjeve të vitit të ri shkollor;
- Në muajin shtator, Drejtoria e Arsimit ka organizuar takim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe koordinatorët e shkollave ku do zhvillohej mësimi me qëndrim tërëditor, takim i cili kishte karakter informues rreth përgatitjeve për fillimin e zbatimit të mësimit me orar të zgjatur dhe caktimin e punëve dhe detyrave për koordinatorët;
- Janë realizuar të gjitha përgatitjet e domosdoshme, në shkolla që do të zhvillohet mësimin me qëndrim tërëditor, nga 3 tetori i vitit shkollor 2016/17, e këto janë: SHFMU "Faik Konica", SHFMU "Model", SHFMU "Afrim Gashi", SHFMU "Emin Duraku", SHFMU "Pjetër Bogdani", dhe SHFMU "Ganimete Tërbeshi";
- Drejtoria e Arsimit, për t'i plotësuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, këtë vit ka hapur edhe tri paralele të reja: në "Shkollën e Gjellbër", në shkollën "Ganimete Tërbeshi" dhe në shkollën fillore "Nëna Terezë" - Vranidoll;

- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kohën e planifikuar ka realizuar shpërndarjen e teksteve shkollore për të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, ku zhvillohet mësimi i obliguar, për vitin shkollor 2016/17;
- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pas iniciativës së nxënësve maturantë, ka ndërmarrë veprime konkrete që 3500 maturantët e komunës së Prishtinës, graduimin të shënojmë për herë të parë në mënyrë të organizuar dhe në një format me karakter festiv.
Synimet e Drejtorisë së Arsimit janë që këtë ceremoni madhështore të bëjmë traditë për çdo vit në komunën tonë;
Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me IPKO-në, kanë organizuar kampin veror të Roboticks, i cili sivjet është mbajtur në shtëpizat e Gërmisë, e të cilat i ka ofruar Komuna enkas për këtë projekt. Në këtë projekt kanë marrë pjesë nxënës e të gjitha shkollave të Kosovës, të cilët gjatë 4 ditëve janë inkurajuar dhe mbështetur të përdorin krijimtarinë dhe imagjinatën në lëmin e robotikës;
- Kontrollimi i kontratave para nënshkrimit, protokollimi i tyre në librin e protokollit, si dhe përgatitja e raportit për MASHT, lidhur me realizimin e nënshkrimit të kontratave për stafin arsimor;
- Aktivitete në komunitetin e të mësuarit së bashku, në bashkëpunim me GIZ dhe aktivitete pas përfundimit të Akademisë për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut;
- Drejtoria e Arsimit, për plotësimin e vendeve të lira, në të gjitha institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar, ka hapur konkurs për 56 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, në konkursin e shpallur më 26.11.2015, dhe në kohë të planifikuar, gjatë muajit janar janë realizuar të gjitha intervistat për këto pozita. Mësimdhënësit e përzgjedhur sipas kualifikimeve dhe performancës së treguar gjatë intervistimit, kanë lidhur kontratë pune;
- Përgatitja dhe shpallja e konkursit për stafin teknik në IEAA, më 15.04.2016;
- Përgatitja dhe shpallja e konkursit për stafin drejtues në IEAA, më 15.04.2016;
- Në procesin e përzgjedhjes së stafit mësimdhënës dhe menaxhues të institucioneve edukativo-arsimore, Drejtoria e Arsimit ka përfshirë gjithnjë përfaqësuesit e Këshillit drejtues, Këshillin e prindërve, të komunitetit dhe të shoqërisë civile;
- Për përzgjedhjen sa më profesionale dhe objektive të stafit arsimor dhe menaxhues të shkollave, janë angazhuar ekspertë të jashtëm;

- Drejtoria e Arsimit, për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar, më 25 korrik 2016, ka hapur konkurs për 96 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, dhe gjatë muajit gusht ka realizuar të gjitha intervistat për këto pozita. Mësimdhënësit e përzgjedhur sipas kualifikimeve dhe performancës së treguar gjatë intervistimit, kanë lidhur kontratë pune;
- Po ashtu, gjatë muajit gusht është formuar komisioni për përzgjedhjen e stafit drejtues në institucioneve edukativo-arsimore, për 18 pozita të shpallura. Pas shqyrtimit të dokumentacioneve të konkurrenteve, Komisioni ka vendosur që tetë pozitat e shpallura për drejtues të institucioneve parashkollore, konkursi të anulohet, ndërsa në dhjetë (10) pozita për drejtues në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, intervistat janë realizuar;
- Drejtoria e Arsimit për angazhimin e studentëve në sferën e arsimit, ka nënshkruar Memorandum mirëkuptimi me Fakultetin e Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina", me qëllim të zyrtarizimit të bashkëpunimit për zbatimin e praktikës profesionale të studentëve të dalluar që përgatiten për mësimdhënës në shkolla, si dhe për krijimin e kushteve për përgatitjen e mësimdhënësve mentorë në shkollat përkatëse.
Duke pasur parasysh se mësimi praktik për mësimdhënësit e ardhshëm zë një vend kyç në formësimin dhe profesionalizimin e tyre, ky Memorandum specifikon hapat konkret të bashkëpunimit dhe përgjegjësitë institucionale për ngritjen e cilësisë në këtë drejtim;
- Drejtoria e Arsimit dhe Qendra për Arsimin e Kosovës (KEC), kanë nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit, që të zbatojnë së bashku projektin "Më mëso mua", gjatë periudhës shtator 2016 - qershor 2018. Ky projekt ka për qëllim aftësimin e mësimdhënësve për t'i shfrytëzuar burimet online në procesin mësimor për implementimin e Kurrikulës, si dhe për zhvillimin e kompetencave të nxënësve, për shfrytëzimin e këtyre burimeve në procesin e përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit të shkathtësive të tyre;
- Në kohë të planifikuar, është hapur konkurs për mësim joformal në pesë (5) institucione edukativo-arsimore në nivelit e arsimit të mesëm të lartë;
- Mësimi joformal në të tri nivelet e arsimit, është duke u realizuar sipas planifikimeve të paraparë;
- Zyrtarët e lartë të arsimit, kanë realizuar vizita kontrolluese në shkollat e nivelit të mesëm të lartë, SHML "28 Nëntori", SHML "Hoxhë K. Prishtina", SHML "Abdyl Frashëri", SHML "Gjin Gazulli" dhe SHML "7 Shtatori" të cilat organizojnë mësim joformal;
- Nënshkrimi i kontratave të stafit arsimor dhe përgatitja e raportit për MASHT-in lidhur me ecurinë e këtij procesi;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit janar-nëntor;

- Realizimi i subvencionimit të IP “Ngjyrat”, i bazuar në komunitet, në shumën prej 10446.00, për mbështetje administrative dhe profesionale, me qëllim të funksionalitetit të IP-së;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues njëzet e katër (24) nxënës dhe të cilët kryesisht vuajnë nga dëmtimet intelektuale dhe fizike, ku komisioni ka rekomanduar tetë (8) nga nxënësit të vijon mësimin në Qendrën burimore “Përparimi” dhe të tjerët në shkollat e rregullta;
- Mbledhja e të dhënave nga institucionet arsimore për pedagogët e nivelit 1-5;
- Përfundimi i raportit për mësimdhënës fillestarë (që kanë filluar karrierën më 01.09.2016) dhe mësimdhënësit e pensionuar në vitin 2015/2016, ose që do të pensionohen gjatë vitit 2016/2017;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kanë organizuar aktivitetin “Ditët me dyer të hapura”, me nxënësit e klasave IX;
- Prezantimi dhe vlerësimi i mësimin tërëditor nga instituti Ed-Guard;
- Drejtoria e Arsimit, në koordinim me gjitha institucionet e nivelit parauniversitar, kanë organizuar aktivitetin “Ta pastrojmë Kosovën”;
- Funksionalizimi i institucionit parashkollor “Shkronjat”, në lagjen “Arbëria”;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla, sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Organizimi i takimit të aktivitetit të drejtorëve;
- Drejtoria e Arsimit, më 21.04.2016, ka shpallur konkursin për bursa komunale;
- Është realizuar shpërndarja e 120 bursave për studentë të komunës së Prishtinës;
- Drejtoria e Arsimit, për nder të ditës ndërkombëtare 1 Qershori, ka organizuar aktivitete “Prishtina lexon”, me nxënësit e arsimit fillor;
- Përgatitja e vendimeve për mësimdhënësit e pranuar nga konkursi i realizuar;
- Hapja e konkursit për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore;
- Përgatitja e 44 kontratave për shërbime të veçanta, të punëtorëve të Kuzhinës Qendrore;

- Disa shkolla ka filluar të kërkojnë këshilla dhe rekomandime, që kanë të bëjnë me ngritjen e sigurisë në shkolla;
- SHFMU "Hilmi Rakovica" ka filluar zbatimin e platformës së sigurisë, duke u mbështetur në platformën për siguri në shkolla të komunës së Prishtinës dhe organizatës KEC;
- Takim me drejtuesit e institucioneve të nivelit parauniversitar, mesimdhënës, nxënës dhe prindër;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për braktisja e nxënësit, në tri nivelit e arsimit parauniversitar, gjatë vitit shkollor 2015/16;
- Drejtoria e Arsimit, në kohë të planifikuar ka realizuar dezinfektimi i institucioneve edukativo-arsimore;
- Mbledhja e të dhënave për përvojën e punës së mesimdhënësve 1990/99;
- Është realizuar lidhja e kontratave me operatorët ekonomikë për transportin e nxënësve në viset rurale;
- Është realizuar vlerësimi i tenderit "Furnizimi me libra për bibliotekat shkollore";
- Gjatë muajit mars, janë furnizuar 29 institucione edukativo-arsimore me pajisje teknologjike (90 kompjuterë, 65 llaptopë dhe 30 projektorë);
- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë furnizuar 5 salla të edukatës fizike me komplet rekuizitat sportive;
- Furnizimi i Kuzhinës Qendrore në mënyrë sistematike me produkte ushqimore;
- Furnizimi në mënyrë sistematike me ushqim-kifle për nxënësit e klasave I-V;
- Furnizimi në mënyrë sistematike me qumësht për nxënësit e klasave I-V;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Shpërndarja e listave të pagave nëpër institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme në mënyrë elektronike;
- Arkivimi i listave të pagave nëpër follderë për secilin muaj kalendarik;
- Përcjellja e kontratës "Rregullimi i xhamave në institucionet arsimore dhe nevojat e Komunës";
- Furnizimi në mënyrë sistematike me naftë, në bazë të kërkesave dhe nevojave të institucioneve arsimore;
- Pajisja e shkollës së mesme "Dr. Ali Sokoli", me kabinet të farmacisë;
- Në kohë të paraparë janë furnizuar të gjitha institucione edukativo-arsimore me lëndë djegëse dru dhe pelet;
- Janë furnizuar 7 shkolla të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët me biblioteka shkollore;

- Gjatë vitit 2016, janë pajisur 14 institucione edukativo-arsimore me kënde të leximit;
- Është realizuar planifikimi i buxhetit për vitin 2016/17 - përpunimi i të dhënave për buxhet BDMS;
- Regjistrimi në databazë i të gjitha lëndëve financiare etj.;
- Janë nënlokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënlokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë zotuar **2600** lëndë për mallra dhe shërbime, si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar **2560** lëndë;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzimet nën 300 €;
- Mbajtja e evidencës e lëndëve të zotuar me modul blerjes, si dhe dorëzimi në prokurim;
- Në funksion të përmirësimit të kushteve infrastrukturore shkollore, në shkollat e komunës së Prishtinës, gjatë muajit shtator, është realizuar ndërtimi i sallës së edukatës fiziket në shkollën fillore “Shkëndija” në Hajvali;
- Gjatë kësaj periudhe është intervenuar nëpër shkolla me kontratën “Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në shkollat dhe institucione tjera komunale”, “Riparimi i gjeneratorëve nëpër institucione arsimore”, “Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave”;
- Sanimi i problemeve të shfaqura në pajisjet elektrike, si në shkollën “Kuzhina Qendrore” problem me njësores, në SHML “Dr. Ali Sokoli”- intervenim në priza etj.;
- Intervenimi në të gjitha raste ku janë paraqitur probleme në kanalizime;
- Janë dhënë instruksionet për adaptimin e hartimit të projektit në IP “Kodra e Trimave”;
- Janë bërë kërkesa për sallën sportive në SHML “Shtjefën Gjeçovi” dhe në MAP për leje ndërtimi;
- Janë bërë kërkesa për pëlqime paraprake të IP “Kodra e Trimave” dhe për laboratorin e SHML “28 Nëntori”;
- Është bërë shpallja e tenderit “Rikonstruktimi i nyjave sanitare” - kontratë kornizë;
- Vazhdojnë punimet te shkolla “7 Marsi” me kontratën “**Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU “7 Marsi”**”;
- Vazhdojnë punimet me kontratën “**Rregullimi i oborrit të shkollës “Ismail Qemali”**”;

- IP “Kodra e Trimave”, janë përfunduar punimet e vrazhda ;
- Me kontratën kornizë "**Rikonstruktimi i nyjave sanitare në disa shkolla të Prishtinës**" - vazhdojnë punimet;
- Me projektin “**Ndërtimi i aneksit në shkollën “Faik Konica”**”- vazhdojnë punimet;
- Vazhdojnë punimet me kontratën “**Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve**” nëpër shkolla;
- Në këtë periudhë kohore është intervenuar në “Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në shkollat dhe institucione tjera komunale”, “Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave”;
- Instalimet e reja të ngrohjes qendrore në shkollat e zonave rurale;
- Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive;
- Po ashtu, me kontratën “Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave” është punuar edhe në objektin e vjetër të Komunës dhe te platoja;
- Intervenimi në shkollën “Gjin Gazulli”, në rregullimin e rrjetit të ujërave të zeza, intervinimi është bërë me kontratë në kuadër të Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale;
- Intervenimi në shkollën “Pavarësia”, në rrethojën e oborrit të shkollës me kontratën “Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave”.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, në institucionet edukativo-arsimore;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet arsimore;
- Përgatitja dhe shpallja e konkursit për stafin teknik në IEAA,
- Përgatitja dhe shpallja e konkursit për stafin drejtues në IEAA,
- Përgatitja e tenderit për pajisjen e shkollave me kamera;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

**5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese;
Planifikimi i buxhetit për periudhën e parë të vitit 2016 (janar-nëntor)**

Kategoria ekonomike	Vlera e alokuar janar-dhjetor 2016	Shpenzimi janar-dhjetor 2016	Zotimet dhe obligimet	Mbetja ne FB
Pagat	18.121.000,00	14.929.282.69	3.039.000.00	152.717.31
10-Mallra shërbime	1.406.268,00	1.443.360.13	18.907.87	0
21-Mallra shërbime	1.161.137,00	1.089.156,90	81.980,10	0
Komunali	620.000,00	557.892,52	62.107,48	0
Subvencione	210.000,00	189.873,00	0	20.127,00
Donacionet	4,004.50	2,000.00	1.950.00	54.50
Kapitalet	2.974.814.53	1.224.873.60	1.749.940,53	1.05
Gjithsej alokimi për viti -2016	24.493.219.53			
Buxheti i planifikuar - 2016	24.934.405,00			
Mjetet e paalokuara - kapitale	441.185,47			

5.1.2. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë periudhës janar-nëntor ka realizuar mbi 1416 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara çdo ditë pune.

5.1.3. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e janarit – nëntor të vitit 2016, është realizuar:

- Takim me përfaqësuesit e Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Takime me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Takime të rregullta me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave;
- Takim me përfaqësuesit e Inspektoratit të Punës;
- Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Takim me përfaqësuesit e Ambasadës gjermane;
- Takim me përfaqësuesit e Bankës gjermane;
- Takim me përfaqësuesit e Ambasadës franceze;
- Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore;
- Takim me përfaqësuesit e Qendrës për punë dhe mirëqenie sociale;
- Takime me organizata të ndryshme joqeveritare;
- Takime me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës;
- Takim me përfaqësuesit e OSBE;
- Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it, lidhur me funksionimin dhe shpenzimet në institucioneve parashkollore me bazë në komunitet;
- Takime me përfaqësuesit e BIT-së;
- Takime me përfaqësuesit e mediave...
- Takim me përfaqësuesit ESBO-së përfaqësues të Finlandës;
- Takime me përfaqësuesit e GIZ;
- Takime me KUR "Prishtina";
- Takime me përfaqësuesit e ndërmarrjes "Termokos";
- Takime me përfaqësuesit e KEDS;
- Takime me përfaqësuesit e KFOR-it;
- Takime me kontraktuesit e transportit për nxënës dhe arsimtarë;

5.1.4. Diskutime publike/takimet me qytetarë

- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët me temë: "Përfshirja mbi drejtësinë tranzicionale në planin mësimorë të edukimit qytetarë në shkolla të mesme";
- SHFMU "Pjetër Bogdani";
- SHML "Eqrem Çabej";

- SHML “Xhevdet Doda”.

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë e Arsimit, kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare ka paraqitur organizata INPO, lidhur me realizimet e konkurseve dhe përzgjedhjes së stafit drejtues dhe mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore, prej vitin 2014 deri më sot;
- Në këtë periudhë raportuese në Drejtorinë e Arsimit është adresuar një kërkesë nga Agjencia Antikorrupsioni, për qasje në pagesa dhe dokumentacion të Petroll Company;
- Kërkesë nga Auditori i Përgjithshëm për qasje në dokumente zyrtare, si: CPO-të e listave të pagave dhe pagesat për mallra dhe shërbime të kontraktuara nga Komuna e Prishtinës;
- Gjatë muajit qershor, kërkesa për qasje në dokumente zyrtare ka paraqitur ZAP- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- Gjatë kësaj periudhe kohore, është adresuar një kërkesë nga prokurimi, për qasje në dokumente zyrtare;

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë periudhës janar-nëntor 2016, në Drejtorinë e Arsimit janë pranuar gjithsej 1702 lëndë, prej tyre:
 - të miratuara 309 lëndë,
 - të refuzuara 804 lëndë,
 - të pezulluara 494 lëndë dhe
 - 95 lëndë janë në proces.

5.1.7. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me përfaqësues të shkollave private;
- Takim me përfaqësuesit e Fakultetit të Filozofik-Psikologjisë;
- Takim me përfaqësuesit e BIT-Austria;
- Takimet me kontraktuesit e transportit për nxënës dhe arsimtarë;
- Takimet me KUR “Prishtina”.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutmi shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesat e mësimdhënësve nga procesi arsimor dhe sigurimi i lehtë i vërtetimeve nga qendrat mjekësore;
- Vijueshmëria e nxënësve;
- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Sfidë gjatë kësaj periudhe ka qenë ballafaqimi me palë të konkursit për bursa, sepse MASHT nuk ka lëshuar vërtetime për mosmarrje të bursës të cilat janë ndarë nga ana e vetë MASHT-it;
- Implementimi i Kurrikulës së re;
- Ndërtimi i objekteve shkollore në disa lagje të qytetit;
- Plotësimi i vendeve të lira me staf arsimor në institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar;
- Sistemimi i mësimdhënësve të cilët janë rrezikuar, si pasojë e ndryshimeve të planit mësimor (fondin e orëve), në shkollat ku është duke u implementuar KKK.

7. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional, sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës;

- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit;
- Sigurimi i hapësirës dhe kushteve të përshtatshme për punë, për stafin e Drejtorisë së Arsimit;

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Shpallja e tenderëve të planifikuar:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e Arsimit;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Organizimi i trajnimeve permanente për zhvillim profesional të personelit edukativo-arsimor, në bashkëpunim me (MASHT, OJQ-të);
- Angazhimi i profesionistëve - ekspertëve në panelet përzgjedhëse;
- Implementimi i mekanizmave të krijuara dhe formularëve standardë për përzgjedhjen e kuadrit udhëheqës-menaxhues dhe profesional nëpër shkolla;
- Përfshirja e përfaqësuesve të Këshillit drejtues, të prindërve dhe komunitetit në procesin e përzgjedhjes së kuadrit menaxhues dhe profesional;
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme qeveritare (MASHT);
- Mentorimi i shkollave gjatë tërë vitit;
- Pajisja me punëtori dhe me firma ushtrimore në shkollat profesionale;
- Organizimi i aktiviteteve të praktikës profesionale, në bashkëpunim me ndërmarrjet publike dhe private;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Përgatitja dhe trajnimi i mësimdhënësve për implementimin e kurrikulit të ri (në bashkëpunim me MASHT, IPK)

- Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve në nivel shkolle;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme: FE, drejtoritë komunale, bibliotekat, muzeun, klubet sportive etj.;
- Mbështetje e vazhdueshme në implementimi i mësimi tërëditorë në shkollat pilot;
- Zbatimi i stimulimit për sukses në menaxhimin e institucionet edukativo-arsimore;
- Analizë dhe statistikë suksesit të gjysmëvjetorit të parë vitit shkollor 2016/17;
- Zhvillimi i mekanizmave të sistemit kualitativ në trajtimin e çështjeve të sigurisë në shkolla;
- Takimet e vazhdueshme me partnerët relevantë për çështjet e sigurisë në shkolla;
- Fillimi i zbatimit të planit të sigurisë në secilën shkollë të komunës së Prishtinës;
- Zotimi i lëndëve me modul blerje;
- Shpenzimi dhe certifikim i lëndëve mallra dhe shërbime;
- Zotimi i lëndëve kapitale;
- Përgatitja e “Petty –Cash”-it për 64 institucione arsimore;
- Barazimi me Bankën Botërore me të dhënat e buxhetit;
- Barazimet dhe kontrolli i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimi i pagave dhe të hyrave vetanake;
- Shpallja e tenderëve të planifikuar;

9. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

- Organizimi dhe realizimi i ekskursioneve në Republikën e Shqipërisë nga nxënësit e nivelit të mesëm të lartë (maturantët), të ndërpriten si të tilla ose të organizohen në nivelin e duhur, në mënyrë që të ketë karakter njohës, edukativ dhe arsimor.